

NEWYORK – PRESBYTERIAN HOSPITAL PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR TË PËRBALLUESHËM

“NewYork-Presbyterian Hospital” ka një politikë të gjatë për të ndihmuar pacientët që marrin shërbime të kujdesit shëndetësor në spitalin tonë dhe që kanë nevojë për ndihmë financiare, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, kombësisë, gjendjes social-ekonomike ose statusit të emigrantit, orientimit seksual apo përkatësisë fetare.

NËSE KENI NJË DETYRIM FINANCIAR NDAJ “NEW YORK – PRESBYTERIAN HOSPITAL” (SPITALI) DHE MENDONI SE NUK JENI NË GJENDJE TA PAGUANI, “NEW YORK – PRESBYTERIAN HOSPITAL (SPITALI PRESBITERIAN I NJU-JORKUT (NYHP))” KA NJË POLITIKË PËR KUJDES SHËNDETËSOR TË PËRBALLUESHËM, E CILA MUND TË NDIHMOJË PACIENTËT E KUALIFIKUAR.

SI TA KUPTOJ NËSE KUALIFIKOHEM PËR KUJDES SHËNDETËSOR TË PËRBALLUESHËM?

- Banorët e Shtetit të Nju-Jorkut mund të kualifikohen për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm për shërbime të nevojshme urgjente mjekësore. Banorët e zonës së shërbimit primar të Spitalit mund të kualifikohen për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm për shërbime të nevojshme jurgjente mjekësore.
- Për “NewYork-Presbyterian/Columbia (duke përfshirë “Morgan Stanley Children’s Hospital of NewYork-Presbyterian”, “NewYork-Presbyterian/Weill Cornell”, “NewYork-Presbyterian/Lower Manhattan” dhe “NewYork-Presbyterian/Allen”, zona e shërbimit primar përbëhet nga pesë njësitë (kontetë) e qytetit të Nju-Jorkut.
- Për “NewYork-Presbyterian/Westchester”, zona e shërbimit primar përbëhet nga kontetë në vijim: Uestçester, Bronks, Orinxh, Putnam dhe Rokland.
- Pacientët që plotësojnë kriteret e mësipërme dhe që kanë të ardhura më të ulëta se shumatat e treguara më poshtë mund të kualifikohen për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.

PERSONAT NË FAMILJE OSE SHTËPI	TË ARDHURAT (EFF. 1.1.2019)
1	49 960 \$
2	67 640 \$
3	85 320 \$
4	103 000\$
PËR ÇDO PERSON TJETËR, SHTONI:	17 680 \$

- Në përgjithësi, kualifikueshmëria për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm do të përcaktohet pas plotësimit të një aplikimi për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.
- Kjo politikë NUK zbatohet për tarifën e mjekëve ose ofruesve të tjerë të kujdesit shëndetësor që faturon në mënyrë të pavarur për shërbimet e tyre. Ofruesit e ACN (klinikave) të Spitalit JANË të mbuluar nga politika për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.

CFARË LLOJ NDIHME MUND TË MARR?

- Spitali nuk do t’i faturon pacientët që kualifikohen për programin e tij për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm më tepër sesa shumatat që i faturohen në përgjithësi (AGB) individëve që kanë sigurime për kujdesin mjekësor urgjent ose kujdes tjetër të nevojshëm mjekësor. Për të gjitha shërbimet e tjera të kujdesit shëndetësor, një individ i kualifikueshëm mund të mos faturon më tepër sesa tarifën bruto të Spitalit. Spitali e llogarit AGB-në duke përdorur metodën prospektive dhe e bazon këtë normë mbi normat aktuale të "Medicaid" për tarifën e shërbimeve në Shtetin e Nju-Jorkut.
- Një plan pagese me këste do të jetë i disponueshëm për pacientët e kualifikueshëm.
- Pas paraqitjes së aplikimit tuaj, mund të shpërfillni çdo faturë derisa të kemi marrë një vendim për atë aplikim.

SI MUND TË APLIKOJ OSE TË MARR PËRGJIGJE PËR PYETJET OË KAM?

- Politika, përmbledhja dhe aplikimi për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm janë të disponueshme në zyrat tona të pranimit ose në faqen tonë të internetit në www.nyp.org nën butonin e Kujdesit Shëndetësor të Përballueshëm, në anglisht dhe në gjuhë të tjera
- Informacioni lidhur me kualifikueshmërinë për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm dhe procesin e aplikimit është i disponueshëm në zyrat e pranimit ose duke na telefonuar **pa pagesë në (866) 252-0101**